VENDIM
Nr.947, datë 2.9.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KOLONJË TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, date 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kolonjë të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
Lista me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 318 (treqind e tetëmbëdhjetë).
2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Kolonjë Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
98-106	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore e sportive.	Në pronësi
112-117	Shërbim funeral	Në pronësi
171-179,184-192,194,195,308, 315	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe, trotuare dhe shërbime publike)	Në pronësi
118-168,303-307,309-314,316-318	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna midis ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
202-209	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës- kanalizimeve.	Në pronësi
302	Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi
14-26	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
40-97	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
180-183	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
27-39,219,244,251,261,266, 276,279,287,291	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi